



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 6 NËNTOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

Dekreti nr. 10922, datë 27.10.2018 “Për shkarkimin e ministrit të Brendshëm” (neni 98 i Kushtetutës dhe nenet 55 e 58 të Rregullores së Kuvendit – votim i hapur me shumicë absolute)

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë deputetë!

Të futet media brenda.

Seancën plenare e deklaroj të hapur.

Atëherë siç jemi njoftuar, sot në rendin e ditës kemi dekretin nr. 10922, datë 27.10.2018 “Për shkarkimin e ministrit të Brendshëm”.

Para se të vazhdojmë me procedurën e dekretit të Presidentit, fjalën e ka kërkuar Kryeministri, zoti Rama.

Edi Rama - Ky Kuvend ka zgjedhur shtatë presidentë të Republikës. Shumë nga ne në këtë sallë kemi votuar për Ilir Metën si President. Atë ditë, ne nuk e kishim shumicën absolute që kemi sot, por sidoqoftë unë kisha bindjen e plotë se Ilir Meta ishte kandidatura më e përshtatshme në rrethanat kur Kuvendi i Shqipërisë duhet të zgjidhte Presidentin e shtatë të Republikës.

Për hir të së vërtetës, që kur hyri në Presidencë, pas asaj dalldisjes fatkeqe rrugëve të Shqipërisë me flamurin e LSI-së, ai e ka justifikuar thuajse plotësisht votën tonë, ka respektuar Kushtetutën, ka peshuar fjalën dhe ka baraspeshuar qëndrimin. Por që prej të shtunës mbrëma ne kemi një problem me Presidentin e Republikës, ose më saktë një problem i krijuar

nga Presidenti i Republikës në punën tonë, si shumicë qeverisëse, na ka mbledhur sot këtu.

Puna jonë është të hartojmë dhe të miratojmë ligje deri kur të kemi besimin e popullit sovran, si dhe të qeverisim deri kur të kemi besimin e të paktën 71 ligjvënësve, të cilët e mishërojnë dhe e ushtrojnë vullnetin e sovranit ndërmjet dy raundeve zgjedhore.

Ne kemi detyrën kushtetuese ta bëjmë këtë punë, pavarësisht nëse e kemi apo jo besimin e kujtdo qoftë tjetër, përfshirë dhe Presidentin e Republikës. Kushdo ka të drejtën e tij të mos na besojë, të na kritikojë, të hidhet edhe përpjetë kundër nesh, po të dojë, por ama askush tjetër, përveç popullit sovran, nuk e ka dhe nuk e merr dot të drejtën të na pengojë në ushtrimin e mandatit tonë kushtetues. Kjo vlen edhe për Presidentin e Republikës.

Kushtetuta i ka të përcaktuara një për një, e zeza mbi të bardhë, të 12 kompetencat e Presidentit të Republikës. Ndër to nuk figuron gjëkund kompetenca e refuzimit të Kryeministrit për sa kohë gëzon besimin e shumicës në parlament dhe, po njësoj, të ministrave që gëzojnë besimin e Kryeministrit. Është pak, por e sigurt, që, nëse do të ekzistonte një kompetencë e tillë, qoftë edhe e fshehur nëpër rreshtat e atyre 12 kompetencave të shkruara qartësisht, nuk ka diskutim që paraardhësi i Ilir Metës nuk do ta kishte lënë pa e zbuluar, dhe edhe pse haptazi partiak, botërisht i njohur si artiljer i zellshëm i Partisë Demokratike, pasi e bombardoi me gjithë furinë e grykës së gojës ministrin e propozuar prej meje, Presidenti i gjashtë i Republikës e firmosi dekretin për atë ministër, me duart e lidhura nga Kushtetuta e Shqipërisë. Sepse Kushtetuta, ua ka thënë copë, në një nen të veçantë, të tërë presidentëve që janë betuar për të, se nuk mund të ushtrojnë asnjë kompetencë tjetër, përveç atyre që u njihen shprehimisht prej saj dhe u jepen me ligje të tjera, të nxjerra në pajtim me të. Pikërisht pse Kushtetuta nuk i njeh Presidentit të Republikës as shprehimisht, as me nënkuptim, e lëre pastaj t'i ketë dhënë me ndonjë ligj të nxjerrë në pajtim me të, kompetencën për të refuzuar propozimet e Kryeministrit për anëtarët e kabinetit qeveritar, Presidenti Ilir Meta ka formuluar një letër refuzimi, pa asnjë referencë kushtetuese apo ligjore.

Ja letra, që mua më ka mbërritur të shtunën mbrëma:

“Lënda: Kthim përgjigjeje për propozimin e emërimit të zotit Sandër Lleshaj, si ministër i Brendshëm.

Zoti Kryeministër, në përgjigje të shkresës suaj nr. 494 datë 27.10.2018, lënda: “Propozim për emërim ministri”, nëpërmjet të cilës zoti Sandër Lleshaj i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar ministër i Brendshëm, dëshiroj t’ju bëj me dije se: Presidenti i Republikës, në cilësinë edhe të Kryetarit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në mbështetje të Kushtetutës, nuk krijoi bindjen e plotë për t’i dhënë besimin kandidaturës së zotit Sandër Lleshaj si ministër i Brendshëm.”

Në mbështetje të Kushtetutës, por se ku është mbështetja, këtu nuk thuhet.

“Në këto kushte, Presidenti i Republikës nuk mund t’i përgjigjet pozitivisht propozimit tuaj për emërimin e zotit Sandër Lleshaj në detyrën e ministrit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Me respekt, Ilir Meta.”

Kjo është letra. Pra, Presidenti i Republikës nuk ka krijuar bindjen e plotë për t’i dhënë besimin e tij kandidaturës së Sandër Lleshit për ministër të Brendshëm (në certifikatë kanë të njëjtën gjë, ky e ka Lleshaj, ai e ka Metaj), prandaj nuk mund t’i përgjigjet pozitivisht propozimit tim.

Keqkuptimi i madh i Presidentit të Republikës është në faktin se unë nuk i kam propozuar atij një kandidat për ministër. Jo, unë Presidentit të Republikës i kam çuar dekretin për një ministër, jo për një kandidat, ministër, të cilin, sipas Kushtetutës sonë, Presidenti nuk e ka kompetencën ta refuzojë, por ka detyrën ta miratojë.

Presidenti i Republikës sonë parlamentare, përveç 12 kompetencave që Kushtetuta ia njeh shprehimisht dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, ia përkufizon qartësisht, ka edhe detyra, siç kanë të gjithë subjektet e Kushtetutës. Ndër këto detyra është edhe detyra për të dekretuar qeverinë, si dhe çdo anëtar të saj, sipas kërkesës së Kryeministrit, madje brenda 7 ditëve me një dispozitë taksative. Nuk lë asnjë vend për interpretim.

Ndërkohë unë, sinqerisht, nuk e kuptoj pse Presidenti i Republikës e ndien të nevojshme të përsërisë, madje me deklaratë zyrtare, se nuk do të lejojë asnjë përpjekje për të sfiduar autoritetin

e tij, sepse unë nuk e kam parë gjëkund një përpjekje të tillë.

Ndërsa personalisht jo vetëm që nuk di të kem bërë ndonjëherë ndonjë përpjekje për të sfiduar autoritetin e Presidentit të Republikës, por as në mendje nuk do ta çoja dot një akt kaq të padobishëm për njerëzit, për qeverinë dhe për mua vetë.

Natyrisht që të gjitha këto unë ia kam thënë Presidentit të Republikës. Si zakonisht kemi pasur edhe pardje një shkëmbim të hapur pozitiv dhe në këndvështrimin tim konstruktiv, pavarësisht mosdakordësisë që kishim dhe vazhdojmë të kemi lidhur me temën e ditës.

Edhe pse, siç e thashë më lart, siç e ka thënë edhe paraardhësi i Ilir Metës, kur, me pahirin më të madh që historia e institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë ka njohur, ai firmosi dekretin për ish-ministrin e Brendshëm, për t'u dekretuar ministër, mjafton të plotësosh kriteret që duhen për t'u bërë deputet, unë nuk pata dhe nuk kam as sot asnjë objeksion pse për gjeneral Sandër Lleshin u kërkuar letra pastërtie si për asnjë ministër në historinë e Republikës, në adresa të pavizituara ndonjëherë më parë nga postieri i Presidencës. Madje e falënderoj edhe publikisht Presidentin për hulumtimin tejet skrupuloz të së kaluarës së largët e të afërt të ministrit të Brendshëm, që ai la pa dekretuar, pavarësisht pastërtisë aq të stërvërtetuar të figurës së tij, sa një mendje e keqe mund të thotë: "Ore, mos është pikërisht kjo pastërti kaq skënderbegase, që e shqetëson Ilir Metën?"

Kjo nuk është mendja ime. Mua mendja ma thotë se kjo nuk mund të jetë e vërtetë, nuk ka se si. Ky, tani për tani, duket si një keqkuptim i pafajshëm me Kushtetutën, në kërkim të një bindjeje të plotë lidhur me ministrin e ri të Brendshëm, në një moment kur gjendja e dëshpëruar e opozitës dhe humbja e plotë e qetësisë së saj e shqetëson me shumë të drejtë Presidentin e Republikës.

Koha e plotë që mori Presidenti, duke shfrytëzuar edhe minutat e fundit të shtatë ditëve me radhë, dhe fakti që në këtë vend, ku edhe xhamia futet në thes me kollajllëkun më të madh, apo prifti bëhet me barrë me lehtësinë më të pashoqe, për gjeneral Sandër Lleshin as Kino-SHQUP-i nuk prodhoi jo ndonjë video apo audio, por qoftë edhe ndonjë fjalë të rëndë goje,

për 7 ditë me radhë, nuk janë pak, si fillim i mbarë për një ministër të Brendshëm.

Prandaj unë nuk e kam humbur besimin se Presidenti i Republikës nuk e ka thënë ende fjalën e fundit për këtë temë, edhe pse afati ka skaduar, ashtu siç nuk e kisha humbur besimin se një tjetër figurë e pastër, e kyçur prej një viti në sirtarin e propozimeve për Presidentin, Helidon Bendo, do të dekretohej drejtor i Shërbimit Informativ, pavarësisht burimeve të sigurta të "cimkave.net" të kohës sonë plot llafe pazaresh të vjetra, të cilat i hedhin përditë kazanit mediatik thashetheme e hakërrima të supozuara presidenciale në 360 gradë.

Sot, Heldion Bendo u dekretua drejtor i SHISH-it dhe jo pse populli thotë më mirë vonë se kurrë, por sepse, realisht, çdo reflektim pozitiv është për t'u përshëndetur, aq më tepër kur reflekton institucioni i Presidentit të Republikës. Unë e përshëndes dekretin presidencial dhe i uroj përzemërsisht drejtorit të ri të Shërbimit të vijojë me sukses punën e nisur dhe ta çojë tani me shpejtësi përpara reformimin e thellë të atij institucioni kyç për sigurinë tonë kombëtare.

Ky lajm i parë i mëngjesit të sotëm ma përforcoi shijen e mirë të takimit që pata me Presidentin, nga ku dola me ndjesinë pozitive të nevojës reciproke për mirëkuptim dhe për një zgjidhje konstruktive, edhe pse është e qartë që nuk ishim aspak me një mendje dhe ende nuk jemi lidhur me arsyen e mosarsyes së dekretimit të ministrit të Brendshëm.

Të njëjtën ndjesi pozitive pata edhe kur e lexova deklaratën e djeshme të Presidentit, pavarësisht mbylljes së dhimbshme të saj me atë shprehjen e bindjes "se koha e drejtimit të shtetit shqiptar me Sekretar të Parë ka përfunduar njëherë e përgjithmonë."

Në një tjetër kohë dhe vend nuk do ta kisha mbytur dot brenda vetes replikën që më erdhi në majë të gjuhës për një mbyllje kaq të pazakontë të një deklarate presidenciale. Nuk do të kisha lënë pa i komentuar edhe referencat e sforcuara që Presidenti i bën vetes ditët e fundit si Komandant i Përgjithshëm apo si Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, si te letra e refuzimit, ashtu edhe te deklarata lidhur me takimin tonë shumë pozitiv.

Por kjo kohë dhe ky vend imponojnë përqendrim te rrugëdalja nga situata e paprecedente që është krijuar prej refuzimit të

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 6 NËNTOR 2018

paprecedent të Presidentit të Republikës për të firmosur dekretimin e një ministri.

Ky është një moment delikat, sepse është vënë në pikëpyetje një ekuilibër i rëndësishëm institucional i vendit. Uroj me gjithë zemër që e gjitha kjo të mos bëhet me një qëllim, që shkon përtej dekretit për gjeneral Sandër Lleshin.

Këtë ia thashë edhe Presidentit, shumë sinqerisht, por koha mos e sjellte që të më duhet ta ndaj me shqiptarët përse po e bëj këtë urim sot.

Unë e di shumë mirë, e dinë të gjithë, Shqipëria ka parë shumë më keq se kaq. Shqipëria ka parë kryeministra që talleshin publikisht me presidentët apo i thoshin publikisht Presidentit “horr bulevardit”.

Shqipëria ka parë presidentë që nuk mblidhnin dot Këshillin e Sigurisë Kombëtare, se nuk u shkonte kush në takim, apo që betoheshin me mustaqe para popullit sovran dhe pastaj shërbenin të rruar nën sqetullën e sovranit pa popull.

Ohu, sa ka parë dhe ka kaluar Shqipëria, krahasuar me këtë furtunën në gotën e besimit dhe të mosbesimit për një ministër të Brendshëm, që si asnjë paraardhës i tij disponon edhe certifikatën më të lartë të sigurisë së NATO-s, të quajtur TOP Cosmic! Por ne s’kemi qenë asnjëherë si ata që i detyruam të largoheshin nga pushteti para 5 vjetësh dhe as si ata që na detyruan t’i largojmë nga koalicioni para një viti. Ne nuk jemi dot si ata që krisjet t’i kthejmë në thyerje, paçka se kemi edhe ne tonat, nuk diskutohet dhe as që vihet në dyshim se ne nuk jemi pa të sharë.

Krisja në këtë rast nuk është personale dhe as politike, është kushtetuese dhe ne jemi këtu, mishërimi i vullnetit të popullit sovran mes dy raundeve zgjedhore, që të bëjmë çmos, në radhë të parë, për ta ngjitur. Uroj të gjejmë edhe nga ana e Presidentit të Republikës dëshirën dhe durimin për të mos e çuar krisjen në thyerje, që, sigurisht, nuk do të jetë fundi i botës, por patjetër është në të mirën e vendit dhe të gjithëve bashkë që ta shmangim. Është e shmangshme.

Është e qartë që, nëse Gjykata Kushtetuese nuk do të ishte në rindërtim për shkak të reformës së thellë, aq shumë të padëshiruar nga shumë të tjerë dhe jo nga Presidenti, në drejtësi, nuk do të ishim përpara kësaj vështirësie që sa është artificiale, është edhe serioze. Fakti që

mungon Gjykata Kushtetuese, fakti që punohet ditën dhe natën për ta bllokuar reformën në drejtësi, nuk është mungesë e pakapërcyeshme për ne.

Ne duhet vetëm të kemi dëshirën për mirëkuptim dhe e kemi.

Durimin për t’i dhënë zgjidhje, në radhë të parë, me mirëkuptim e kemi.

Vendosmërinë për të arritur qëllimin, që është baza e ekzistencës, mbrojtja e Kushtetutës, e kemi.

Me këto të tria, mungesa e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese është e kapërcyeshme. Nëse edhe Presidentit të Republikës nuk do t’i mungojë qoftë njëra nga këto të tria, dëshira për mirëkuptim, kjo krisje zhduket në pak kohë.

Sidoqoftë, ne do t’ia bëjmë hyzmetin këtij procesi dhe do të vazhdojmë të komunikojmë me Presidentin në ditët në vijim.

Këtu kam një ndjesë dhe realisht shumë ndjesë për Presidentin, në radhë të parë, nëse ajo që do të shtoj këtu, në kllapa, është një sajese mediatike, por, meqë më informuan dhe përsëri e konfirmova sot, duke qenë se vetë nuk i disponoj në ekranin e shtëpisë kanalet e klubeve mediatike të Shqipërisë, që përmes një gazetari në një klub mbrëmë, shefi i kabinetit të Presidentit paska hedhur me sms dorashkën presidenciale për t’iu drejtuar grupit tonë parlamentar, apo krejt Kuvendit nuk e di, me dyer të mbyllura, për të rrëfyer arsyen e vërtetë të mosdekretimit, që mos o Zot, mos qoftë ajo që unë ende s’e besoj që ma kanë dëgjuar veshët në takimin me të, madje jam gati të pranoj që kam probleme me veshët, para se të pranoj që ma ka thënë Presidenti i Republikës atë arsye. Në vendin ku unë jetoj me kujtimet dhe ëndrrat e mia, mirë se të vijë zoti President dhe të na rrëfejë me dyer të mbyllura apo të hapura, vetëm me ne apo bashkë me gjysmën e familjes sonë politike këtu në parlament, gjithçka që e ka mbajtur përbrenda, me shumë gjasë pa arritur dot të ma thotë në sy! Por mos qoftë ajo që më kanë thënë mua, larg qoftë! Çdo gjë mund ta përballoj, por një President qesharak për atdheun tim nuk mund të përballoj dot.

Të dashura kolege, të dashur kolegë,

Më vjen mirë që ne këtu kemi një dakordësi të plotë në këtë moment, kur dëshira për mirëkuptim shumëkujt i ngjan si dobësi, durimi për të gjetur një zgjidhje shumëkujt i ngjan si

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 6 NËNTOR 2018

pamundësi, vendosmëria në arritjen e qëllimit shumëkujt mund t'i ngjajë si vetëngushëllim, për sa kohë që Presidenti i papranueshëm qëndron përballë nesh si fakt i kryer, por më besoni që nuk është kështu. Koha më ka mësuar që unë të mos e them fjalën e fundit të parën dhe vendi më ka mësuar që ta respektoj radhën e lëvizjes.

Sot do të votojmë shkarkimin e Fatmir Xhafajt, të cilin e falënderoj edhe një herë për kontributin që dha. Më pas do të vendosim në qeveri ministrin e Brendshëm, të refuzuar nga Presidenti për dekretim, natyrisht në drejtimin e Ministrisë së Brendshme si zëvendësministër dhe do t'i japim ca ditë kohë, jo vetëm Presidentit të Republikës që ta bluajë këtë çështje dhe të punojë për të krijuar bindje të plotë, por edhe vetes për të hedhur hapin tjetër.

Dua ta mbyll fjalën time para jush duke ju falënderuar ju dhe të gjithë ata të njohur dhe të panjohur që brenda vendit dhe jashtë tij, përmes mesazheve të panumërta dhe të një lumi të pafundmë komentesh në rrjetet sociale e kanë shprehur me një forcë të madhe mbështetjen për gjeneralin, që nga sot do të drejtojë punët e brendshme të Shqipërisë. Kam shumë besim se jo vetëm nuk do të zhgënjëjë askënd në punën e tij, por do t'u japë një shtysë të fortë dhe të domosdoshme përpara punëve të brendshme. Shtatë ditë e pamjaftueshme që Presidenti mori për të krijuar bindjen e tij, mua më tepruan për të konsoliduar më tej bindjen time se gjeneral Sandër Lleshi, në krye të punëve të brendshme, është njeriu i duhur, i cili vjen në kohën e duhur dhe gjendet në vendin e duhur si përfaqësues i shumicës së duhur, sot dhe nesër, i Republikës së Shqipërisë.

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Përpara se të kalojmë në votim, më lejoni t'ju rikujtoj, së pari nenin 98 të Kushtetutës, sipas të cilit ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve dhe së dyti, dekreti, sipas Kushtetutës, shqyrtohet brenda 10 ditësh nga Kuvendi.

Propozohet nga Kryeministri dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës zoti Fatmir Xhafaj, ministër i Brendshëm.

Procedura e votimit është elektronike. Votimi është i hapur dhe lejohet vetëm një votim me shumicë absolute votash.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë 75 deputetë prezentë.

Hapet votimi për dekretin e Presidentit, për shkarkimin e zotit Fatmir Xhafaj, si ministër i Brendshëm.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

(Miratohet dekreti.)

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 10:40)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi